

VENDIM
Nr. 392, datë 30.6.2021

**PËR PËRCAKTIMIN E SPECIALITETEVE NË FORCAT E ARMATOSURA TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

(ndryshuar me VKM-në nr. 386, datë 29.6.2023)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1/1, të nenit 21, të ligjit nr. 59/2014, “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e specialiteteve në Forcat e Armatosura, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur dhe pjesë e pandarë e këtij vendimi.
 2. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

SHTOJCA 1

Në kuptim të këtij vendimi, “specialitet” konsiderohet aftësia profesionale që oficeri/nënoficeri ka në momentin e titullimit për nevoja të FA-së, për shkak të arsimimit dhe kualifikimit në një fushë të caktuar të ekspertizës, që ushtrohet vetëm në funksione të caktuara në tabelën e organizimit dhe të pajisjeve të strukturave të FA-së, është kritik për funksionalitetin dhe operacionalitetin e strukturave dhe nuk është i ndërkëmbyeshëm me funksione apo pozicione të tjera.	
Specialiteti	Kriteret
1 Mjekësi/Infermieri	1.1 “Mjek” – oficeri, i cili ka përfunduar studimet e larta në Universitetin e Mjekësisë brenda e jashtë vendit dhe ushtron detyrën e tij në një pozicion me specialitet të përcaktuar në TOP si “mjek”. 1.2 “Infermier” – oficeri/nënoficeri i cili ka përfunduar studimet e larta për infermieri brenda ose jashtë vendit dhe ushtron detyrën e tij në një pozicion me specialitet të përcaktuar në TOP si “infermier”.
2 Dirigjent/instrumentist , muzikant (Orkestra Frymore e FA-së, Banda)	“Dirigjent/instrumentist, muzikant (Orkestra Frymore e FA-së, Orkestra Simfonike e FA-së, Banda)” – oficeri/nënoficeri që ka përfunduar arsimim e lartë në Universitetin e Arteve ose atë të mesëm artistik (për një instrument muzikor të caktuar) brenda ose jashtë vendit dhe ushtron detyrën e tij në një funksion organik në bandën frymore të FA-së, ose në Orkestrën Simfonike të FA-së, në përputhje me formimin (diplomën) e tij.
3 Vëzhgim ajror/trafik ajror	Vëzhgim ajror/trafik ajror – oficeri/nënoficeri, i cili ka përfunduar studimet e larta në shkollën e Forcës Ajrore (Akademi Ajrore) dhe/ose shkollë tjetër të profilit të ngjashëm brenda ose jashtë vendit dhe ushtron detyrën e tij në një funksion organik në strukturën e FA-së (Forca Ajrore), në përputhje me formimin (diplomën) e fituar.
4 Motorist në anije	“Motorist në anije” – nënoficeri, i cili ka kryer të paktën arsimin e mesëm profesional brenda ose jashtë vendit ose ka kryer kurs/trajnim dhe është certifikuar si motorist/mekanik nga Qendra e Formimit Profesional dhe ushtron detyrën e tij në funksionin motorist/kryemotorist/elektracist i motorëve ndihmues në anije ose instruktor i përgatitjes mekanike (motorist) në Qendrën Stërvitore Bazë Detare, në Forcën Detare.
5 Jurist	“Jurist” – oficeri, i cili ka përfunduar studimet në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë në fushën e drejtësisë ose arsimin juridik të barasvlershëm me të, sipas përcaktimeve të ligjit përkatës për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë, dhe ushtron detyrën e tij në një pozicion me specialitet të përcaktuar në TOP, si “jurist/këshilltar ligjor”, prej një periudhë jo më pak se 2 (dy) vitesh.

6	Kimist/biolog/fizikant	“Kimist/biolog/fizikant” – oficeri/nënoficeri, i cili ka përfunduar studimet e larta ose shkollë tjetër të profilit të shkencave të natyrës, brenda dhe jashtë vendit, ose ka kryer kurset e nevojshme përkatëse dhe ushtron detyrën e tij në një funksion organik në strukturën e FA-së, si pjesë e shërbimit të MADM-së, në përputhje me formimin (diplomën, kursin) e fituar.
---	-------------------------------	--